

MOUNTING AND OPERATING INSTRUCTIONS



EB 2512 SQ

Përkthim i udhëzimeve origjinale



Vavlul universal për reduktimin e presionit i tipit 41-23
Rregullatorë presioni me vetë-operim

Botimi janar 2021



Shënim për këto udhëzime montimi dhe operimi

Këto udhëzime montimi dhe operimi ju ndihmojnë në montimin dhe operimin e pajisjes në mënyrë të sigurt. Udhëzimet janë të detyrueshme për trajtimin e pajisjeve SAMSON. Imazhet e paraqitura në këto udhëzime janë vetëm për qëllime ilustruese. Produkti i vërtetë mund të ketë ndryshime.

- Për përdorimin e sigurt dhe të duhur të këtyre udhëzimeve, lexojini ato me kujdes dhe mbajini ato për t'iu referuar në të ardhmen.
- Nëse keni pyetje lidhur me këto udhëzime, kontaktoni shërbimin e pas-shitjes së SAMSON (aftersaleservice@samsongroup.com).



Udhëzimet e montimit dhe të operimit për pajisjen, përfshihen në paketim. Dokumentacionin më të fundit e gjeni në faqen tonë të internetit në www.samsongroup.com > **Service & Support** > **Downloads** > **Documentation**.

Përcaktimi i fjalëve sinjalizuese

RREZIK

Situatat e rrezikshme, të cilat, nëse nuk shmangen, do të shkaktojnë vdekjen ose lëndime serioze.

PARALAJMËRIM

Situatat e rrezikshme, të cilat, nëse nuk shmangen, mund të shkaktojnë vdekjen ose lëndime serioze.

SHËNIM

Mesazh për dëmtimin e pronës ose keqfunksionim

Shënim

Informacione shtesë

Këshillë

Veprimi i rekomanduar

1	Udhëzimet dhe masat e sigurisë.....	1-1
1.1	Shënime mbi lëndimet e mundshme të rënda.....	1-4
1.2	Shënime mbi lëndimet e mundshme.....	1-5
1.3	Shënime mbi dëmtimet e mundshme të pronës.....	1-6
1.4	Paralajmërimi në rregullator.....	1-9
2	Shënimet në pajisje	2-1
2.1	Etiketat e të dhënave	2-1
2.2	Vendndodhjet e etiketës së të dhënave	2-2
2.3	Numrat identifikues të materialit.....	2-2
2.3.1	Valvuli i tipit 2412	2-2
2.3.2	Aktuatori i tipit 2413.....	2-2
3	Ndërtimi dhe parimi i operimit.....	3-1
3.1	Reduktorë shtesë	3-3
3.2	Të dhënat teknike	3-4
4	Dërgimi dhe transportimi në vend	4-1
4.1	Pranimi i mallrave të dorëzuar	4-1
4.2	Heqja e paketimit nga valvuli dhe aktuatori	4-1
4.3	Transporti dhe ngritja e rregullatorit	4-2
4.3.1	Transporti dhe rregullatorit.....	4-2
4.3.2	Ngritja e rregullatorit	4-3
4.4	Ruajtja e valvulit	4-4
5	Instalimi.....	5-1
5.1	Kushtet e instalimit	5-1
5.2	Përgatitja për instalimin	5-4
5.3	Instalimi	5-6
5.3.1	Instalimi i rregullatorit.....	5-6
5.3.2	Pastrimi i tubacionit.....	5-7
5.4	Testi i rregullatorit.....	5-8
5.4.1	Testi i rrjedhjeve.....	5-9
5.4.2	Testi i presionit.....	5-9
5.5	Izolimi.....	5-10
5.5.1	Izolimi për temperatura të lëndës mbi 150 °C	5-10
5.5.2	Izolimi në të ftohtë.....	5-10

Përmbajtja

6	Vënia në punë.....	6-1
6.1	Ndezja e impiantit.....	6-2
6.1.1	Rregullimi i lëngjeve.....	6-2
6.1.2	Rregullimi i avullit.....	6-2
7	Operimi.....	7-1
7.1	Rregullimi i pikës së caktuar.....	7-1
8	Defektet.....	8-1
8.1	Zgjidhja e problemeve.....	8-1
8.2	Veprimi i emergjencës.....	8-3
9	Shërbimi.....	9-1
9.1	Përgatitja e valvulit për proceset e shërbimit.....	9-4
9.2	Instalimi i rregullatorit pas proceseve të shërbimit.....	9-4
9.3	Proceset e shërbimit.....	9-4
9.3.1	Ndërrimi i aktuatorit.....	9-5
9.3.2	Ndërroni sustat e pikës së caktuar.....	9-6
9.3.3	Ndërrimi i folesë dhe tapës.....	9-7
9.3.4	Ndërrimi i diafragmës së operimit.....	9-7
9.4	Porositja e pjesëve të këmbimit dhe furnizimeve të operimit.....	9-8
10	Heqja nga puna.....	10-1
11	Heqja.....	11-1
11.1	Heqja e valvulit nga tubacioni.....	11-1
11.2	Heqja e aktuatorit nga valvuli.....	11-1
12	Riparimet.....	12-1
12.1	Kithimi i pajisjeve tek SAMSON.....	12-1
13	Hedhja.....	13-1
14	Certifikatat.....	14-1
15	Shtojcë.....	15-1
15.1	Çiftet rrotulluese.....	15-1
15.2	Lubrifikanti.....	15-1
15.3	Mjetet.....	15-1
15.4	Aksesorët.....	15-1
15.5	Pjesët e këmbimit.....	15-2
15.6	Shërbimi pas shitjes.....	15-4

1 Udhëzimet dhe masat e sigurisë

Përdorimi i synuar

Rregullatori SAMSON i tipit 41-23 është një rregullator presioni. Përbëhet nga një valvul i tipit 2412 dhe një aktuator i tipit 2413. Valvuli dhe aktuatori (përveç rregullatorëve të testuar) dorëzohen veçmas dhe duhet të montohen së bashku sipas këtyre udhëzimeve.

Rregullatori me vetë-operim përdoret për të kontrolluar presionin e rrjedhës së poshtme p2 në tubacion në pikën e caktuar përkatësisht. Lëngjet, gazet dhe avujt në impiantet përpunuese dhe industriale mund të kontrollohen nga rregullatori.

Rregullatorët janë bërë për të punuar në kushte të përcaktuara saktë (p.sh. presioni i punës, lënda e procesit, temperatura). Prandaj, operatorët duhet të sigurohen që rregullatorët të përdoren vetëm në kushte pune që plotësojnë specifikimet e përdorura për zgjedhjen madhësisë së pajisjeve në fazën e porosijes. Në rast se operatorët synojnë t'i përdorin rregullatorët në aplikime ose kushte të tjera përveç atyre të specifikuara, kontaktoni SAMSON.

SAMSON nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmtimet që vijnë nga mospërdorimi i pajisjes për qëllimin e synuar ose për dëmtimet e shkaktuara nga forcat e jashtme ose ndonjë faktor tjetër i jashtëm.

➔ Shikoni të dhënat teknike dhe etiketën e të dhënave për limitet dhe fushat e aplikimit si edhe përdorimet e mundshme.

Keqërdorimi i parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme

Rregullatorët nuk janë të përshtatshëm për aplikimet e mëposhtme:

- Përdorimi jashtë kufijve të përcaktuar gjatë zgjedhjes së madhësisë dhe nga të dhënat teknike
 - Përdorimi jashtë kufijve të përcaktuar nga rekorderitë shtesë të montuara në rregullator
- Për më tepër, veprimtaritë e mëposhtme nuk përputhen me përdorimin e synuar:
- Përdorimi i pjesëve të këmbimit joorigjinale
 - Kryerja e proceseve të shërbimit dhe riparimit, që nuk janë përshkruar në këto udhëzime

Kualifikimet e personelit të operimit

Rregullatori duhet të montohet, të vihet në punë, të mirëmbahet ose të riparohet vetëm nga personeli i trajnuar dhe kualifikuar plotësisht; duhet të zbatohen kodet dhe praktikat e pranuar të industrisë. Sipas këtyre udhëzimeve të montimit dhe operimit, personeli i trajnuar i referohet individëve të cilët janë në gjendje të gjykojnë punën që u është caktuar dhe të dallojnë rreziqet e mundshme në sajë të trajnimit të tyre të specializuar, njohurisë dhe përvojës së tyre, si edhe njohurisë për standardet që zbatohen.

Udhëzimet dhe masat e sigurisë

Pajisjet personale mbrojtëse

Ju rekomandojmë të kontrolloni rreziqet që mund të shkaktojnë lëndë e procesit që po përdoret (p.sh. ► Databaza e substancave të rrezikshme GESTIS (CLP)). Në varësi të lëndës së procesit dhe/ose veprimtarisë, mjetet mbrojtëse që nevojiten janë:

- Veshje, doreza dhe syze mbrojtëse në aplikime me lëndë të nxehta, të ftohta dhe/ose gërryese
 - Vishni mbrojtëse për veshët kur punoni afër valvulit
 - Kasketë e fortë
 - Ripa lidhës sigurie kur punoni në lartësi
 - Këpucë mbrojtëse, këpucë me ESD (shkarkesë elektrostатike), nëse nevojitet
- ➔ Konsultohuni me operatorin e impiantit për detaje mbi mjete të tjera mbrojtëse.

Rishikimet dhe modifikimet e tjera

Rishikimet, konvertimet ose modifikimet e tjera të produktit nuk autorizohen nga SAMSON. Ato bëhen me rrezikun e marrë përsipër nga vetë përdoruesi dhe mund të çojnë në rreziq sigurie, për shembull. Për më tepër, produkti mund të mos përmbushë më kërkesat për përdorimin e synuar të tij.

Paralajmërimet kundër rreziqeve të mbetura

Për të shmangur lëndimet personale ose dëmtimet e pronës, operatorët e impiantit dhe personeli i operimit duhet të parandalojë rreziqet që mund të shkaktohen në rregullator nga lëndë e procesit, presioni i punës ose nga pjesët lëvizëse, duke marrë masat paraprake të përshtatshme. Ata duhet të respektojnë gjithë deklaratat për rreziqet, paralajmërimet dhe shënimet për të pasur kujdes në këto udhëzime montimi dhe pune.

Rreziqet që rezultojnë nga kushtet e veçanta të punës në vendin e instalimit të rregullatorit, duhet të identifikohen në një vlerësim risku dhe të parandalohen përmes udhëzimeve përkatëse të sigurisë, të hartuara nga operatori.

Ju rekomandojmë gjithashtu të kontrolloni rreziqet që mund të shkaktojnë lëndë e procesit që po përdoret (p.sh. ► Databaza e substancave të rrezikshme GESTIS (CLP)).

- ➔ Respektoni masat e sigurisë për trajtimin e pajisjes dhe masat mbrojtëse për parandalimin e zjarrit dhe të shpërthimeve.

Veçoritë e sigurisë

Rregullatori i tipit 41-23 nuk ka veçori sigurie. Kur lirohet nga presioni, rregullatori hapet nga forca e sustave të pikës së caktuar.

Përgjegjësitë e operatorit

Operatori është përgjegjës për operimin e duhur dhe zbatimin e rregullave të sigurisë. Operatorët janë të detyruar t'ia sigurojnë këto udhëzime montimi dhe operimi si edhe dokumentet e referencës personelit të operimit dhe t'i udhëzojnë për përdorimin e duhur. Për më tepër, operatori duhet të sigurohet që personeli i operimit ose personat e tretë të mos ekspozohen ndaj asnjë rreziku.

Operatori është gjithashtu përgjegjës për të garantuar që do të respektohen kufijtë e specifikuar tek të dhënat teknike të produktit. Kjo vlen edhe për procedurën e ndezjes dhe të fikjes. Procedura e ndezjes dhe e fikjes është brenda kuadrit të detyrave të operatorit dhe si e tillë, nuk është pjesë e këtyre udhëzimeve të montimit dhe operimit. SAMSON nuk mund të bëjë deklaratat lidhur me proceset, pasi detajet e punës (p.sh. presionet dhe temperaturat diferenciale) ndryshojnë për çdo rast individual dhe janë të njohura vetëm nga operatorit.

Përgjegjësitë e personelit të operimit

Personeli i operimit duhet të lexojë dhe të kuptojë këto udhëzime montimi dhe operimi si edhe dokumentet e referencës dhe të zbatojë deklaratat e sigurisë, paralajmërimet dhe shënimet për kujdes të specifikuar në to. Për më tepër, personeli i operimit duhet të njihet me rregullat që zbatohen për shënëdetin, sigurinë dhe parandalimin e aksidenteve dhe t'i përmbahet atyre.

Standardet dhe rregulloret e referuara

Rregullatorët janë në pajtim me kërkesat e direktivës evropiane 2014/68/EU për pajisjet e presionit. Rregullatorët me shënimin CE kanë një deklaratë konformiteti të BE e cila përfshin informacione rreth procedurës së aplikuar për vlerësimin e konformitetit. Kjo deklaratë konformiteti e BE është përfshirë në paragrafin "Certifikatat".

Sipas vlerësimit të rrezikut për ndezjen të bërë sipas EN 13463-1:2009, pjesa 5.2, rregullatorët jolektrikë nuk kanë burimin e tyre të ndezjes së mundshme edhe në rastin e rrallë të një defekti në operim. Si rezultat, ato nuk janë brenda kuadrit të direktivës 2014/34/EU.

→ Për lidhjen me një sistem lidhjeje ekupotenciale, zbatoni kërkesat e specifikuar në paragrafin 6.4 të EN 60079-14 (VDE 0165 Pjesa 1).

Udhëzimet dhe masat e sigurisë

Dokumentacioni i referencës

Përveç këtyre udhëzimeve për montimin dhe operimin, zbatohen edhe dokumentet e mëposhtme:

- Udhëzimet e montimit dhe operimit për
 - p.sh. **Aksesorët: Dhoma e kompensimit** ▶ EB 2595
 - p.sh. **Sitë e tipit 2 NI** ▶ EB 1015
- Fletë të dhënash për
 - p.sh. **Aksesorët: Dhoma e kompensimit · Rekorderi me vidë · Lidhja e linjës së kontrollit · Linja e kontrollit** ▶ T 2595
 - p.sh. **Sitë e tipit 2 NI** ▶ T 1015
- Udhëzimet e montimit dhe të operimit, si dhe fletët e të dhënave për rekorderitë shtesë (p.sh. valvulat mbyllëse, matësit e presionit etj.)

1.1 Shënime mbi lëndimet e mundshme të rënda

RREZIK

Rrezik i plasjes së pajisjeve të presionit.

Rregullatorët dhe tubacionet janë pajisje presioni. Presioni i palejuar ose hapja e papërshtatshme mund të bëjnë që komponentët e valvulit të plasin.

- Respektoni presionin maksimal të lejuar për rregullatorin dhe impiantin.
- Para se të filloni çdo lloj pune në rregullator, hiqni presionin nga të gjitha pjesët e prekura të impiantit dhe të rregullatorit.
- Zbrazeni lëndën e procesit nga të gjitha pjesët e prekura të impiantit dhe nga rregullatori.

1.2 Shënime mbi lëndimet e mundshme

⚠ PARALAJMËRIM

Rrezik shtypjeje që lind nga pjesët lëvizëse.

Rregullatori përmban pjesë lëvizëse (sustat e pikave të caktuara) i cili mund të lëndojë duart ose gishtat nëse futen në rregullator.

- Mos i futni duart ose gishtat midis sustave të pikës së caktuar ndërkohë që rregullatori është në punë.
- Mos i futni duart ose gishtat midis kolonave dhe sustave të pikës së caktuar ndërkohë që rregullatori është në punë.
- Mos i futni duart ose gishtat midis pllakës së sustës dhe traversës ndërkohë që rregullatori është në punë.
- Para se të kryeni çdo lloj pune në rregullator, hiqni presionin nga impianti. Shkëputni ose mbyllni linjën e kontrollit.

Rrezik lëndimi personal përmes proceseve, përdorimit ose instalimit të pasaktë, si rezultat i informacionit të pallexueshëm në rregullator.

Me kalimin e kohës, shenjat, etiketat dhe etiketat e të dhënave mbi rregullator mund të mbulohen me papastërti ose të bëhen të pallexueshme në ndonjë mënyrë tjetër. Si rezultat, rreziqet mund të kalojnë pa u vënë re dhe udhëzimet mund të mos ndiqen. Ka rrezik lëndimi personal.

- Mbajini të gjitha shenjat dhe mbishkrimet mbi pajisje në gjendje të lexueshme.
- Rinovoni menjëherë etiketat e të dhënave ose etiketat ngjithëse të dëmtuara, të pasakta ose që mungojnë.

Rrezik humbjeje të dëgjimit ose shurdhim për shkak të zhurmës së lartë.

Emetimet e zhurmës varen nga versioni i valvulit, strukturat e impiantit dhe lënda e procesit.

- Vishni mbrojtëse për sytë kur punoni afër valvulit.

Rrezik djegieje për shkak të komponentëve dhe tubacioneve të nxehta ose të ftohta.

Në varësi të lëndës së procesit, komponentët e rregullatorit dhe tubacionet mund të nxehen ose të ftohen shumë dhe të shkaktojnë djegieje.

- Lëri komponentët dhe tubacionet të ftohen ose të ngrohen.
- Vishni veshje mbrojtëse dhe doreza sigurie.

⚠ PARALAJMËRIM

Dëmtim për shëndetin sipas rregullores REACH.

Nëse pajisja SAMSON përmban një substancë e cila është renditur si substancë me nivel të lartë shqetësimi në listën e kandidatëve të rregullores REACH, kjo rrethanë specifikohet në shënimin e dërgesës së SAMSON.

- Për informacione mbi përdorimin e sigurt të pjesës së prekur, shiko
▶ <http://www.samson.de/reach-en.html>.

Rrezik lëndimi personal për shkak të lëndës së procesit të mbetur në rregullator.

Ndërsa punoni në rregullator, mund të dalë lënda e mbetur e procesit dhe, në varësi të karakteristikave të saj, mund të çojë në lëndime personale, p.sh. djegie (kimike).

- Nëse është e mundur, zbrazeni lëndën e procesit nga të gjitha pjesët e prekura të impiantit dhe nga rregullatori.
- Vishni veshje mbrojtëse, doreza sigurie dhe syze mbrojtëse.

Rrezik lëndimi personal për shkak të sustave në tension.

Sustat e pikave të caktuara të rregullatorëve me pikë të caktuar të rregulluar, janë të shtypura paraprakisht dhe janë nën tension.

- Para se të filloni me proceset në sustë, lironi kompresionin nga sustat e shtypura paraprakisht.

1.3 Shënime mbi dëmtimet e mundshme të pronës

ⓘ SHËNIM

Rrezik dëmtimi i rregullatorit për shkak të rripave të lidhur gabim.

- Mos i lidhni rripat mbajtës në kasën e aktuatorit.

! SHËNIM

Rezëk dëmtimi i rregullatorit për shkak të karakteristikave të papërshtatshme të lëndës.

Rregullatori është ndërtuar për një lëndë procesi me karakteristika të përcaktuara.

→ Përdorni vetëm lëndën e procesit të specifikuar për madhësinë e valvulës.

Rezëk dëmtimi i rregullatorit për shkak të ndotjes (p.sh. grimcat e ngurta) në tubacion.

Operatori i impiantit është përgjegjës për pastrimin e tubacioneve në impiant.

→ Shpëlani tubat para se ta vini në punë.

Rezëk dëmtimi i rregullatorit për shkak të përdorimit të lubrifikantëve të papërshtatshëm.

Lubrifikantët që duhen përdorur varen nga materiali i rregullatorit. Lubrifikantët e papërshtatshëm mund të gërryejnë dhe të dëmtojnë sipërfaqen.

→ Përdorni vetëm lubrifikantët e aprovuar nga SAMSON.

Nëse keni dyshime, këshillohuni me SAMSON.

Rezëk rrjedhjeje dhe dëmtimi të rregullatorit për shkak të çifteve rrotulluese tepër të larta ose tepër të ulëta.

Respektoni çiftet e specifikuar rrotulluese gjatë shtrëngimit të komponentëve të rregullatorit. Çiftet rrotulluese tepër të larta bëjnë që pjesët të konsumohen më shpejt. Pjesët që janë shumë të lira mund të shkaktojnë rrjedhje.

→ Mbani parasysht forcat e specifikuar për shtrëngimin (shihni shtojcën).

Rezëk dëmtimi i rregullatorit për shkak të përdorimit të veglave të papërshtatshme.

Nevojiten mjete të caktuara për të punuar në rregullator.

→ Përdorni vetëm mjetet e aprovuara nga SAMSON.

Nëse keni dyshime, këshillohuni me SAMSON.

! SHËNIM

Rrezik ndotjeje e lëndës së procesit nga përdorimi i lubrifikantëve të papërshtatshëm dhe/ose veglave dhe komponentëve të ndotur.

- Mbajeni rregullatorin dhe veglat e përdorura larg tretësirave dhe grasos.
- Sigurohuni që të përdorni vetëm lubrifikantë të përshtatshëm.

Rrezik që presioni i tepërt të dëmtojë pjesët e impiantit për shkak të rrjedhjeve që lidhen me ndërtimin, përmes rregullatorit.

- Futni gjithmonë një pajisje sigurie (p.sh. valvul sigurie nga presioni i tepërt ose valvul shkarkimi sigurie) në impiant.

Kontroll i pasaktë për shkak të formimit të akullit në rregullator.




Temperaturat e lëndës nën 0 °C mund të shkaktojnë formimin e akullit në rregullator, në varësi të lagështisë së ajrit. Kjo mund të ndikojë veçanërisht në funksionimin e tapës ose udhëzuesit me bosht të diafragmës.

- Parandaloni formimin e akullit duke marrë masat e nevojshme (p.sh. mbylljen, ngrohës etj.). Operatori i impiantit është përgjegjës për zgjedhjen dhe zbatimin e masave të duhura parandaluese. Shihni paragrafin 'Instalimi'.

i Shënim

Shërbimi i pas-shitjes së SAMSON mund t'ju mbështesë përsa i përket lubrifikantëve, çifteve rrotullues dhe veglave të miratuara nga SAMSON.


1.4 Paralajmërim në rregullator

Paralajmërim	Kuptimi i paralajmërimit	Vendndodhja e pajisjes
<p>Kujdes! Mos e çmontoni valvulin pa nxjerrë tensionin nga susta e pikës së caktuar.</p>	<p>Paralajmërim për të specifikuar që susta e pikës së caktuar janë ngarkuar. Ka një rrezik lëndimi të rëndë të kokës ose të fytyrës nga shtendosja e papritur e sustave të pikës së caktuar, ndërkohë që zhvidhosni traversën kur susta e pikës së caktuar janë të ngarkuara.</p>	
<p>Hiqeni plotësisht tensionin nga susta e pikës së caktuar para se të çfiletoni dy dadot.</p>	<p>Paralajmërim për të specifikuar që susta e pikës së caktuar janë ngarkuar. Ka një rrezik lëndimi për duart dhe gishtat nga lirimi i papritur i boshtit të aktuatorit, nëse i futni midis traversës dhe sustave të pikës së caktuar, ndërkohë që këmbëhet aktuatori.</p>	
<p>Zhbllokoni/ zhbllokoni boshtin e tapës</p>	<p>Paralajmërim për të specifikuar dëmtim të pronës në gominën e shakullit. Ka një rrezik dëmtimi të gominës së shakullit për shkak të montimit të pasaktë ose të heqjes së boshtit të tapës.</p>	


2 Shënimet në pajisje

Në pajisje janë fiksuar disa etiketa të dhënash. Etiketat e të dhënave përdoren për të identifikuar komponentët e veçantë të rregullatorit (shihni Fig. 2-1).

2.1 Etiketat e të dhënave



2.2 Vendndodhjet e etiketës së të dhënave



2.3 Numrat identifikues të materialit

2.3.1 Valvuli i tipit 2412

Shihni etiketën e të dhënave (11, materiali i trupit ANSI/DIN). Për më shumë detaje mbi etiketën e të dhënave, shihni paragrafin 2.1.

2.3.2 Aktuatori i tipit 2413

Duke e specifikuar këtë numër materiali, mund të na kontaktoni për të mësuar se çfarë materiali është përdorur. Numri i materialit, specifikohet tek etiketa e të dhënave (3, numri i materialit ANSI/DIN). Për më shumë detaje mbi etiketën e të dhënave, shihni paragrafin 2.1.

3 Ndërtimi dhe parimi i operimit

→ Referojuni Fig. 3-1

Valvuli i reduktimit të presionit e tipit 41-23 përbëhet nga një valvul mbyllës i tipit 2412 dhe një aktuator i tipit 2413. Valvuli dhe aktuatori (përveç rregullatorëve të testuar) dorëzohen veçmas dhe duhet të montohen së bashku sipas këtyre udhëzimeve (shihni paragrafin 'Instalimi').

Valvuli i reduktimit të presionit përdoret për të ruajtur presionin në rrjedhën e poshtme të valvulit në një pikë të caktuar të rregulluar.

Lënda e procesit rrjedh përmes valvulit midis folesë (2) dhe tapës (3) në drejtimin e specifikuar nga shigjeta në trup. Pozicioni i tapës së valvulit përcakton shpejtësinë e rrjedhës dhe si rezultat, raportin e presionit nëpër valvul.


Boshti i tapës është i mbyllur me një shakull pa fërkim (5.1). Presioni i rrjedhjes së poshtme p2 transmetohet në dhomën e kompensimit (18) (për lëngjet mbi 150 °C dhe për avujt) dhe linja e kontrollit (17) tek diafragma e operimit (12) (shakulli i operimit (12.1) në versionin me aktuator shakulli) ku konvertohet në forcë pozicionimi. Kjo forcë përdoret për të lëvizur tapën e valvulit në varësi të forcës së sustave të pikës së caktuar (7).. Forca e sustës është e rregullueshme në rregulluesin e pikës së caktuar (6). Valvulat me K_{VS} 4 dhe më lart kanë shakulli i balancimit (4). Presioni i rrjedhës së sipërme vepron në pjesën e jashtme të shakullit, ndërsa presioni i rrjedhës së poshtme në pjesën e brendshme të shakullit. Si rezultat, forcat e prodhuara nga presioni i rrjedhës së sipërme dhe i rrjedhës së poshtme që veprojnë në tapë zhbalancohen.

Në varësi të valvulit dhe aktuatorit të përdorur, rregullatori mund të përditësohet për të krijuar një valvul reduktimi presioni për shpejtësitë e ulëta të rrjedhës, një valvul reduktimi presioni për avullin ose një valvul reduktimi presioni me siguri të lartë (aktuator me dy diafragma).

Valvuli mbyllet kur presioni i rrjedhës së poshtme rritet.

Legjenda për Fig. 3-1

- 1 Trupi i valvulit
- 2 Foleja
- 3 Tapa
- 4 Shakulli i balancimit
- 5 Boshti i tapës
- 5.1 Shakulli
- 6 Rregullatori i pikës së caktuar
- 7 Sustat e pikës së caktuar
- 7.1 Pllaka e sustës
- 8 Traversa
- 8.1 Kolona (pamja e vizatuar e rrotulluar me 90°)
- 8.2 Dadot për kolonat
- 8.3 Vrimat e mbyllura
- 9 Dadot e shtrëngimit
- 10 Aktuator me diafragmë/aktuatori i shakullit
- 11 Boshti i aktuatorit
- 12 Diafragma e operimit
- 12.1 Shakulli i operimit
- 13 Pllaka e diafragmës
- 14 Dadoja e pllakës së diafragmës
- 15 Dadot dhe buzonat
- 16 Lidhnja e linjës së kontrollit G ¼ (me bashkuese vide me kufizim kur përdoret me avull)
- 17 Linja e kontrollit (dorëzohet në vend) (e disponueshme si seti i linjës së kontrollit për lidhjen e drejtpërdrejtë të presionit në trup ► T 2595)
- 18 Dhoma e kompensimit
- 19 Tapa e mbushjes
- 20 Kapaku i ndalimit të lëvizjes me kunjën me dy maja



3.1 Reduktorë shtesë

→ Referojuni Fig. 3-2

Sita

Rekomandojmë të instaloni një sitë SAMSON (2) në rrjedhën e sipërme të valvulit. Nuk lejon që grimcat e ngurta në lëndën e procesit të dëmtojnë rregullatorit.

- Mos e përdorni sitën për të filtruar lëndën e procesit në mënyrë të përhershme.
- Zgjidhni një sitë (përmasat e rretës) të përshtatshme për lëndën e procesit.

Shënim

Çdo papastërti që merr me vete lënda e procesit mund të ndikojë negativisht në funksionimin e duhur të rregullatorit. Rekomandojmë të instaloni një sitë (p.sh. e tipit SAMSON 2 NI) në rrjedhën e sipërme të valvulit të reduktimit të presionit (► EB 1015).

Matësit e presionit

Instaloni një matës presioni (3 dhe 5) në rrjedhën e sipërme dhe rrjedhën e poshtme të rregullatorit për të monitoruar presionet që mbizotërojnë në impiant.




Fig. 3-2: Aplikimi i kampionit

Ndërtimi dhe parimi i operimit

Valvulat e bajpasit dhe të mbylljes

Rekomandojmë të instaloni një valvul mbylljeje (1 dhe 6) në rrjedhën e sipërme të sitës dhe në rrjedhën e poshtme të rregullatorit dhe të instaloni një linjë bajpasi. Bajpasi siguron që impianti të mos ketë nevojë të mbyllet për procese shërbimi dhe riparimi në rregullator.

Izolimi

Rregullatorët mund të izoloohen për të reduktuar transferimin e energjisë së nxehtësisë.

Referojuni udhëzimeve në paragrafin 'Instalimi'.

Emetimi i zhurmës

Pjesët me ndarës rrjedhe mund të përdoren për të pakësuar emetimin e zhurmës (shiko u). (► T 2512).

i Shënim

Rregullatori i tipit 41-23 nuk është një valvul sigurie. Nëse nevojitet, duhet të instalohet një mbrojtës mbipresioni në pjesën e impantit.

3.2 Të dhënat teknike

Etiketat e të dhënave të valvulit dhe të aktuatorit japin informacione rreth versioneve të valvulit dhe të aktuatorit (shihni paragrafin 'Shenjat mbi pajisje').

i Shënim

Më shumë informacion gjenden në fletën e të dhënave ► T 2512.

Pajtuueshmëria

Rregullatori i tipit 41-23 mban markën CE dhe EAC të konformitetit.

CE

EAC

Materiali i procesit dhe shtrirja e aplikimit

Valvuli i reduktimit të presionit i tipit 41-23 përdoret për të ruajtur presionin në rrjedhën e poshtme të rregullatorit në një pikë të caktuar të rregulluar.

- Për lëngjet, gazet dhe avujt
- Temperatura maksimale **350 °C**
- Pikat e caktuara nga **0.05 deri 28 bar**
- Përmasat e valvulit **DN 15 deri 100**
- Vlerat e presionit nga **PN 16 deri 40**

Rregullatori hapet kur çlirohet presioni.

Valvuli **mbyllet** kur presioni i **rrjedhës së poshtme** rritet.

Gama e temperaturës

Në varësi të mënyrës se si konfigurohet rregullatori, ai mund të përdoret deri në temperatura 350 °C (shihni Tabela 3-1). Temperatura minimale është e kufizuar nga aksesorët e përdorur dhe materiali i diafragmës së aktuatorit (► T 2595).

Kategoria e rrjedhjes

Rregullatori prej metali ka rrjedhje të kategorisë I sipas IEC 60534-4.

Rregullatori me fole të butë ka rrjedhje të kategorisë IV sipas IEC 60534-4.

Emetimi i zhurmës

SAMSON nuk mund të bëjë deklarata të përgjithshme mbi emetimin e zhurmës pasi varet nga versioni i rregullatorit, strukturat e impiantit dhe lënda e procesit dhe kushtet e punës.

Përmasat dhe peshat

Tabela 3-5 jep një përmbledhje të dimensioneve dhe peshave. Gjatësitë dhe lartësitë në diafragmat e përmasave shfaqen në faqen 3-10.

Tabela 3-1: Të dhënat teknike · Të gjitha presionet në bar (matësi)

Valvul		Tipi 2412				
Madhësia e valvulit		DN 15 deri 50	DN 65 deri 80	DN 100		
Vlera e presionit		PN 16, 25 ose 40				
Presioni maksimal diferencial i lejuar Δp		25 bar	20 bar	16 bar		
Temperatura maksimale e lejuar	Valvul	▶ T 2500 · Diagrama e temperaturës së presionit				
	Tapa e valvulit	Mbyllëse metal: 350 °C · PTFE mbyllëse e butë: 220 °C EPDM ose FKM mbyllëse e butë: 150 °C · NBR mbyllëse e butë: 80 °C				
Kategoria e rrjedhjes sipas IEC 60534-4		Rrjedhje e mbyllëses së metalit e kategorisë I ($\leq 0.05\%$ e koeficientit K_{VS}) Mbyllëse e butë: rrjedhje e kategorisë IV ($\leq 0.01\%$ e koeficientit K_{VS})				
Pajtueshmëria		CE EAC				
Aktuator me diafragmë		Tipi 2413				
Sipërfaqja e aktuatorit	cm ²	640	320	160	80	40
Gamat e pikës së caktuar	bar	0.05 deri 0.25 0.1 deri 0.6	0.2 deri 1.2	0.8 deri 2.5 ²⁾	2 deri 5	4.5 deri 10 8 deri 16
Temperatura maksimale e lejuar		Megjithatë, gazet 350 °C , maksimumi 80 °C tek aktuatori · Lëngjet 150 °C , me dhomë kompensimi 350 °C · Avull me dhomë kompensimi 350 °C				
Aktuatori i shakullit		Tipi 2413				
Sipërfaqja e aktuatorit	cm ²	33		62		
Gamat e pikës së caktuar	bar	10 deri 22 · 20 deri 28		2 deri 6 ¹⁾ · 5 deri 10 bar		
Susta e pikës së caktuar		8000 N				

1) Susta e pikës së caktuar 4400 N

2) Version me aktuator me dy diafragma: 1 me 2.5 bar

Ndërtimi dhe parimi i operimit

Tabela 3-2: Presioni maksimal i lejuar në aktuator

Gamat e pikës së caktuar		Presioni maksimal i lejuar mbi pikën e caktuar të rregullar në aktuator
Aktuator me diafragmë	0,05 me 0,25 bar · 0,1 me 0,6 bar	0,6 bar
	0.2 deri 1.2 bar	1,3 bar
	0.8 deri 2.5 bar	2,5 bar
	2 deri 5 bar	5 bar
	4,5 me 10 bar · 8 me 16 bar	10 bar
Aktuatori i shakullit	2 me 6 bar · 5 me 10 bar	6,5 bar
	10 deri 22 bar	8 bar
	20 deri 28 bar	2 bar

i Shënim

Presioni maksimal i lejuar në aktuator varet nga pika e caktuar e rregulluar aktualisht. Shtoni në të vlerën e listuar në tabelë.

Shembull:

Gama e pikës së caktuar: 0.2 deri 1.2 bar

Pika e caktuar e rregulluar: 0,8 bar

Presioni maksimal i lejuar në aktuator: 0.8 bar + 1.3 bar = **2.1 bar**

Tabela 3-3: Koefficientët K_{VS} dhe vlerat x_{FZ} · Kushtet për përllogaritjen e nivelit të zhurmës sipas VDMA 24422 (botimi 1.89)

Madhësia e valvulit	DN	15	20	25	32	40	50	65	80	100
$K_{VS}^{1)}$ · Version standard		4,0	6,3	8,0	16	20	32	50	80	125
x_{FZ}		0,5	0,45	0,4					0,35	
$K_{VS}^{1)}$ · Version special		1,0	1,0 · 4,0		4,0 · 8,0			32 ²⁾		80
x_{FZ}		0,6		0,5		0,45		0,4		
$K_{VS}^{1)}$ · Me ndarës rrjedhe		3,0	5,0	6,0	12	15	25	38	42	66

¹⁾ $K_{VS} \leq 4$: valvul pa shakull balancimi

²⁾ Maksimumi i lejuar Δp : 25 bar

Tabela 3-4: Materialet · Numrat e materialeve sipas DIN EN

Valvul		Tipi 2412			
Vlera e presionit		PN 16	PN 25	PN 40	
Temperatura maksimale e lejuar		300 °C	350 °C		
Kasa		Gizë EN-GJL-250	Hekur grafit sferoidal EN-GJS-400-18-LT	Çelik i derdhur 1.0619	Çelik inoks 1.4408
Foleja		Çelik CrNi			Çelik CrNiMo
Tapa	Materiali	Çelik CrNi			Çelik CrNiMo
	Gominë	PTFE me fibrë xhami 15 % · EPDM · NBR · FKM			
Unazë drejtimi		Çelik CrNi			
Shakulli i balancimit dhe gomina e shakullit		Çelik inoks 1.4571			
Aktuatori		Tipi 2413			
		Aktuator me diafragmë		Aktuatori i shakullit	
Kasa e diafragmës		1,0332 ¹⁾		-	
Diafragma		EPDM · FKM · NBR · EPDM me PTFE veshje mbrojtëse		-	
Trupi i shakullit		-		1.5415/1.4301 (vetëm çelik inoks)	
Shakulli		-		1.4571	

¹⁾ Në versionet rezistente ndaj gërryerjes (çelik CrNi)

Tabela 3-5: Përmasat në mm dhe peshat në kg

Valvuli i reduktimit të presionit		Tipi 41-23								
Madhësia e valvulit		DN 15	DN 20	DN 25	DN 32	DN 40	DN 50	DN 65	DN 80	DN 100
Gjatësia L		130	150	160	180	200	230	290	310	350
Lartësia H1		335			390		510		525	
Lartësia H2	Çelik i harkëtuar	53	-	70	-	92	98	-	128	-
	Materiale të tjera	44			72		98		118	
Lartësia H4		100								

¹⁾ +10 % për gjithë materialet e tjera

²⁾ Aktuatori me dy diafragma: 1 me 2.5 bar

³⁾ Aktuatori me dy diafragma: Lartësia H me 50 mm

Ndërtimi dhe parimi i operimit

Tabela 3-5: Përmasat në mm dhe peshat në kg

Valvuli i reduktimit të presionit		Tipi 41-23								
Madhësia e valvulit		DN 15	DN 20	DN 25	DN 32	DN 40	DN 50	DN 65	DN 80	DN 100
Version standard me aktuator me diafragmë e tipit 2413										
Gamat e pikës së caktuar	0.05 deri 0.25 bar	Lartësia H ³⁾	445		500		627		650	
		Aktuatori	ØD = 380 mm, A = 640 cm ²							
		Forca e sustës së valvulit F	1750 N							
	0.1 deri 0.6 bar	Lartësia H ³⁾	445		500		627		650	
		Aktuatori	ØD = 380 mm, A = 640 cm ²							
		Forca e sustës së valvulit F	4400 N							
	0.2 deri 1.2 bar	Lartësia H ³⁾	430		480		607		635	
		Aktuatori	ØD = 285 mm, A = 320 cm ²							
		Forca e sustës së valvulit F	4400 N							
	0.8 me 2.5 bar ²⁾	Lartësia H ³⁾	430		485		612		635	
		Aktuatori	ØD = 225 mm, A = 160 cm ²							
		Forca e sustës së valvulit F	4400 N							
	2 deri 5 bar	Lartësia H ³⁾	410		465		592		615	
		Aktuatori	ØD = 170 mm, A = 80 cm ²							
		Forca e sustës së valvulit F	4400 N							
	4.5 deri 10 bar	Lartësia H ³⁾	410		465		592		615	
		Aktuatori	ØD = 170 mm, A = 40 cm ²							
		Forca e sustës së valvulit F	4400 N							
8 deri 16 bar	Lartësia H ³⁾	410		465		592		615		
	Aktuatori	ØD = 170 mm, A = 40 cm ²								
	Forca e sustës së valvulit F	8000 N								
Pesha për versionet me aktuator me diafragmë e tipit 2413										
Gamat e pikës së caktuar	0.05 deri 0.6 bar	Pesha, bazuar në gizë 1, rreth kg	22,5	23,5	29,5	31,5	35	51	58	67
	0.2 deri 2.5 bar		16	18	23,5	25,5	29	45	52	61
	2 deri 16 bar		12	13	18,5	21	24	40	47	56

1) +10 % për gjithë materialet e tjera

2) Aktuatori me dy diafragma: 1 me 2.5 bar


3) Aktuatori me dy diafragma: Lartësia H me 50 mm

Tabela 3-5: Përmasat në mm dhe peshat në kg

Valvuli i reduktimit të presionit		Tipi 41-23									
Madhësia e valvulit		DN 15	DN 20	DN 25	DN 32	DN 40	DN 50	DN 65	DN 80	DN 100	
Version me aktuatorin e shakullit t tipit 2413											
Gamat e përkës së caktuar	2 deri 6 bar	Lartësia H	550		605		732		755		
		Aktuatori	ØD = 120 mm, A = 62 cm ²								
		Forca e sustës së valvulit F	4400 N								
	5 deri 10 bar	Lartësia H	550		605		732		755		
		Aktuatori	ØD = 120 mm, A = 62 cm ²								
		Forca e sustës së valvulit F	8000 N								
	10 deri 22 bar	Lartësia H	535		590		717		740		
		Aktuatori	ØD = 90 mm, A = 33 cm ²								
		Forca e sustës së valvulit F	8000 N								
	20 deri 28 bar	Lartësia H	535		590		717		740		
		Aktuatori	ØD = 90 mm, A = 33 cm ²								
		Forca e sustës së valvulit F	8000 N								
Pesha për versionin me aktuator shakulli											
Gamat e përkës së caktuar	2 deri 10 bar	Pesha, bazuar në gizë 1, rreth kg	16,5	17,9	18	23,5	25,5	29	48	56	66
	10 deri 28 bar		20,9	21,5	22	27,5	29,5	33	54	65	75

- 1) +10 % për gjithë materialet e tjera
- 2) Aktuatori me dy diaphragma: 1 me 2.5 bar
- 3) Aktuatori me dy diaphragma: Lartësia H me 50 mm

Vizatimet e përmasave



4 Dërgimi dhe transportimi në vend

Puna që përshkruhet në këtë paragraf duhet të kryhet vetëm nga një personel i kualifikuar përkatësisht.

4.1 Pranimi i mallrave të dorëzuar

Pas marrjes së ngarkesës, veproni si më poshtë:

1. Kontrolloni shtrirjen e dërgesës.
Kontrolloni nëse specifikimet në etiketën e të dhënave të valvulit dhe të aktuatorit përputhen me specifikimet në fletën e dorëzimit. Shihni paragrafin "Shenjat mbi pajisje" për detaje mbi etiketën e të dhënave.
2. Kontrolloni ngarkesën për dëmtime transporti. Raportoju SAMSON dhe agjentit të dërgesës çdo dëmtim (referoju fletës së dorëzimit).
3. Përcaktoni peshën dhe dimensionet e njësisë që do të ngrihen dhe do të transportohen, në mënyrë që të zgjidhni pajisjen e përshtatshme ngritëse dhe aksesorët e ngritjes. Referoju dokumenteve të transportit dhe paragrafit 'Projekti dhe parimi i punës'.

4.2 Heqja e paketimit nga valvuli dhe aktuatori

Komponentët e rregullatorit (valvuli, aktuatori, nëse aplikohet, dhe linja e kontrollit) jepen në dorëzim veçmas. Rregullatori i testuar jepet në dorëzim si një njësi e montuar.

Veproni si më poshtë për të ngritur dhe instaluar valvulën:

- Mos e hapni ose mos e hiqni paketimin deri në momentin para ngritjes për instalimin të valvulës në tubacion.
- Lëri komponentët e rregullatorit në kontejnerin e transportit ose mbi paletë për ta transportuar në vend.
- Mos i hiqni kapakët mbrojtës nga hyrja dhe dalja, deri në momentin para instalimit të valvulës në tubacion. Ato parandalojnë hyrjen e grimcave të huaja në valvul.
- Hidhni dhe ricikloni paketimet sipas rregullave lokale.

4.3 Transporti dhe ngritja e rregullatorit

RREZIK

Rrezik për shkak të rrëzimit të ngarkesave të varura.

- Qëndroni larg nga ngarkesat e varura ose që lëvizin.
- Mbyllni dhe siguroni vendkalimet e transportit.

PARALAJMËRIM

Rrezik i rrëzimit të pajisjeve ngritëse dhe rrezik dëmtimi nga aksesorët e ngritjes për shkak të tejkalimit të kapacitetit nominal të ngritjes.

- Përdorni vetëm pajisjet dhe aksesorët e aprovuar, kapaciteti minimal ngritës i të cilave është më i lartë se pesha e valvulit (duke përfshirë aktuatorin dhe paketimin, nëse ka).
- Për peshat, referojuni dokumenteve të transportit dhe paragrafit 'Projekti dhe parimi i punës'.

PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi për shkak të ngritjes së pasaktë, pa përdorimin e pajisjes ngritëse.

Ngritja e rregullatori pa përdorimin e pajisjes ngritëse mund të shkaktojë lëndime (lëndim të shpinës veçanërisht) në varësi të peshës së rregullatorit.

- Respektoni peshën e udhëzuar për trajtimin me dorë: 15 deri në maksimumi 55 kg duke marrë parasysh moshën, gjininë dhe gjendjen fizike

- Respektoni rregulloret për shëndetin dhe sigurinë në punë, të vlefshme në vendin e përdorimit.

PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi personal për shkak të rrëzimit të rregullatorit.

- Respektoni qendrën e gravitetit të rregullatorit.
- Sigurojeni rregullatorin që të mos bjerë ose rrokulliset.

Këshillë

Shërbimi ynë i pas-shitjes mund të sigurojë me kërkesë udhëzime më të detajuara për transportin dhe ngritjen.

4.3.1 Transporti dhe rregullatorit

Rregullatori mund të transportohet duke përdorur pajisje ngritëse (p.sh. vinç ose pirun).

- Lëreni rregullatorin në konejnerin e transportit ose mbi paletë për ta transportuar.
- Zbatoni udhëzimet e transportit.

Udhëzimet e transportit

- Mbrojeni rregullatorin nga ndikimet e jashtme (p.sh. goditjet).
- Mos e dëmtoni mbrojtësen nga gërryerja (bojë, lyerjet e sipërfaqes). Riparoni menjëherë çdo dëmtim.
- Mbroni nga dëmtimi tubacionin dhe aksesorët e montuar të valvulit.

- Mbrojeni rregullatorin nga lagështia dhe papastërtitë.
- Temperatura e lejuar e ambientit të rregullatorëve standardë është -20 deri në +80 °C.

4.3.2 Ngritja e rregullatorit

Për të instaluar një rregullator të madh në tubacion, përdorni pajisje ngritjeje (p.sh. vinç ose pirun) për ta ngritur.

Udhëzimet e ngritjes

- Përdorni një çengel me shul sigurie për të fiksuar rripat kundër rrëshqitjes ngjatë ngritjes dhe transportimit (shihni Fig. 4-1).
- Sigurojini rripat që të mos bien.
- Sigurohuni që rripat të mund të hiqen pas instalimit.
- Mos e lejon rregullatorin të anohet ose rrëzohet.
- Mos i lini ngarkesat të varura kur ndërprisni punën për kohë të gjatë.
- Sigurohuni që aksi i tubacionit të jetë gjithmonë horizontal gjatë ngritjes dhe aksi i boshtit të tapës të jetë gjithmonë vertikal.

Ngritja

1. Lidhni një rrip në secilën fllanxhë të trupit dhe në mjetin ngritës (p.sh. çengel) të vinçit ose pirunit (shiko Fig. 4-1).
2. Ngrijeni me kujdes rregullatorin. Kontrolloni nëse mjeti ngritës dhe aksesorët mund ta mbajnë peshën.
3. Lëvizeni rregullatorin me kujdes deri në vendin e instalimit.
4. Instalojeni rregullatorin në tubacion (shihni paragrafin 'Instalimi').
5. Pas instalimit në tubacion, kontrolloni nëse fllanxhat e rregullatorit janë shtrenguar mirë me bulona.
6. Hiqni rripat.




Fig. 4-1: Vizatimi skematik i pikave ngritëse në rregullator

4.4 Ruajtja e valvulit

SHËNIM

Rrezik dëmtimi i rregullatorit për shkak të ruajtjes jo të mirë.

- Zbatoni udhëzimet për ruajtjen.
- Shmangni ruajtjen për kohë të gjatë.
- Kontaktoni SAMSON në rast kushtesh të ndryshme të ruajtjes ose ruajtjes për kohë të gjatë.

Shënim

Rekomandojmë që ta kontrolloni rregullisht rregullatorin dhe kushtet e ruajtjes gjatë ruajtjes për periudha të gjata.

Udhëzime për ruajtjen

- Mbrojeni rregullatorin nga ndikimet e jashtme (p.sh. goditjet).
- Fiksojeni rregullatorin në pozicionin e ruajtur në mënyrë të tillë që të mos bjerë ose rrëshqasë.
- Mos e dëmtoni mbrojtësen nga gërryerja (bojë, lyerjet e sipërfaqes). Riparoni menjëherë çdo dëmtim.
- Mbrojeni rregullatorin nga lagështia dhe papastërtitë. Ruajeni në lagështi relative prej më pak se 75%. Në hapësira të lagështa, mos lejoni kondensimin. Nëse është e nevojshme, përdorni një agjent tharjeje ose ngrohje.
- Sigurohuni që temperatura e ambientit të jetë pa acide ose materiale të tjera gërryese.

- Temperatura e lejuar e ruajtjes së rregullatorëve standardë është -20 deri në +65 °C.
- Mos lini asnjë objekt mbi rregullator.

Udhëzime të veçanta për ruajtjen e elastomerëve.

Elastomer, p.sh. diafragma e operimit

- Për t'i mbajtur elastomeret në formë dhe për të mos lejuar plasaritjen, mos i përthyeri ose mos i varni.
- Mbajini elastomeret larg nga lubrifikantët, lëndët kimike, solucionet dhe karburantet.
- Rekomandojmë që elastomeret të ruhen në temperaturë 15 °C.

Këshillë

Departamenti i pas shitjes i SAMSON mund t'ju japë udhëzime ruajtjeje me të detajuara me kërkesë.

5 Instalimi

Puna që përshkruhet në këtë paragraf duhet të kryhet vetëm nga një personel i kualifikuar posaçërisht për kryerjen e këtyre proceseve.

5.1 Kushtet e instalimit

Pozicioni i punës

Pozicioni i punës për rregullatorin është pamja e përparme e gjithë kontrolleve të punës në rregullator (duke përfshirë çdo rekorderi shtesë), që shihen nga pozicioni i personelit të punës.

Operatorët e impiantit duhet të sigurojnë që pas instalimit të pajisjes, personeli i punës të mund t'i kryejë gjithë proceset e punës në mënyrë të sigurt dhe të ketë lehtësisht qasje tek pajisja nga pozicioni i punës.

Rrugëzimi i tubacionit

Gjatësitë e hyrjes dhe të daljes ndryshojnë në varësi të disa faktorëve të ndryshëm dhe kushteve të procesit, dhe nuk duhet të konsiderohen si rekomandime. Kontaktoni SAMSON nëse gjatësitë janë shumë më të shkurtra sesa gjatësitë e rekomanduara.

Për t'u siguruar që rregullatori funksionon mirë, veproni si më poshtë:

- Respektoni gjatësitë e hyrjes dhe daljes (shih Tabela 5-1). Kontaktoni SAMSON nëse kushtet e rregullatorit ose të lëndës së procesit devijojnë.
- Instalojeni rregullatorin pa sforcë dhe me sa më pak dridhje të jetë e mundur. Lexoni informacionet tek 'Pozicioni i montimit' dhe 'Mbështetja ose varja' në këtë paragraf.

- Për lëndët që kanë tendencë të kondensohen, instaloni tubacionin me një pjerrësi të lehtë të rrjedhës së poshtme në të dyja anët, në mënyrë që lënda e kondensuar të shkarkohet siç duhet. Nëse rrjedha e sipërme dhe ajo e poshtme e tubacionit të rregullatorit lëvizin vertikalisht me drejtim për lart, nevojitet një shkarkim automatik.
- Instalojeni rregullatorin duke lënë hapësirë të mjaftueshme për të hequr aktuatorin dhe valvulin ose për të kryer ndonjë shërbim riparimi në to.

Pozicioni i montimit

Për t'u siguruar që rregullatori funksionon mirë, veproni si më poshtë:

- Instalojeni kasën e aktuatorit me sustat e pikës së caktuar, të varura për poshtë në tubacionet horizontale (shih Fig. 5-1).
- Sigurohuni që drejtimi i rrjedhës të përputhet me drejtimin e treguar nga shigjeta në trup.
- Kontaktoni SAMSON nëse pozicioni i montimit nuk është siç specifikohet më lart.


! SHËNIM

Dëmtim për shkak të ngrirjes.

Mbrojeni rregullatorin nga ngrirja kur kontrolloni lëndët që mund të ngrijnë. Nëse rregullatori nuk është instaluar në vende ku nuk ka ngricë, hiqeni atë nga tubacioni kur impianti është i fikur.

i Shënim

Mos instaloni asnjë instrument (p.sh. rregullatorë temperature ose valvuli mbyllës) që kufizojnë diametrin e tubit midis pikës së lidhjes së presionit dhe rregullatorit.



¹⁾ Me kërkesë: Lejohet për rregullatorë me udhëzues me bosht tape të fiksuar dhe me temperaturë të lëndës deri në 80 °C. Jo për avull.

Mbështetja ose varja

i Shënim

Kompania e prodhimit të impiantit është përgjegjëse për zgjedhjen dhe aplikimin e një mbështetjeje ose varjeje të përshtatshme të rregullatorit të instaluar dhe të tubacionit.

Në varësi të versionit të rregullatorit dhe pozicionit të montimit, valvuli i kontrollit dhe tubacioni duhet të mbështeten ose të varen.

! SHËNIM

Mos lidhni mbajtëse direkt në valvul ose aktuator.

Linja e kontrollit

Linja e kontrollit duhet të vendoset në vendin e instalimit, p.sh. një tub $\frac{3}{8}$ " për avull ose një tub 8x1 ose 6x1 mm për ajër/ujë.

Lidhni linjën e kontrollit në linjën e rrjedhës së poshtme (p_2) të paktën një metër larg daljes së valvulit.

Saldoni linjën e kontrollit në anë, në mes të tubit duke e anuar në një raport prej rreth 1:10 deri në dhomën e kompensimit. Nëse ka një manikotë në rrjedhën e poshtme të valvulit të reduktimit të presionit, lidhni valvulin me manikotën edhe nëse është disa metra larg (shih Tabela 5-1 dhe Fig. 5-2).

Seti i linjës së kontrollit

Seti i linjës së kontrollit të presionit të lidhjes në trupin e valvulit është i disponueshëm si pjesë aksesorësh nga SAMSON.




Fig. 5-2: Lidhja e linjës së kontrollit, në varësi të mënyrë që rrugëzohet tubacioni

Dhoma e kompensimit

Dhoma e kondensimit (18) nevojitet për lëngjet mbi 150 °C si edhe për avullin. Pozicioni i montimit të dhomës së kompensimit është treguar me një etiketë ngjyeshme mbi vetë dhomën si edhe me një shigjetë dhe fjalën "lart" të stampuar sipër dhomës.

Ky pozicion montimi duhet zbatuar; përndryshe nuk mund të garantohet funksionimi i sigurt i rregullatorit të reduktimit të presionit.

Saldoni linjën që vjen nga pika e lidhjes në folenë e tubit $\frac{3}{8}$ " në dhomë.

Instaloni dhomën e kompensimit në pikën më të lartë të tubacionit. Si rrjedhojë, linja e kontrollit midis dhomës së kompensimit dhe aktuatorit duhet të instalohet gjithashtu me një pjerrësi për poshtë. Në këtë rast, përdorni një tub $\frac{3}{8}$ " me pjesë vidhosjeje të reja.

Nëse linja e kontrollit ndodhet poshtë mesit të flanaxhës së hyrjes së valvulit, rregulloni dhomën e kompensimit në të njëjtin nivel si flanaxha e hyrjes. Në këtë rast, përdorni një tub i cili është të paktën $\frac{1}{2}$ " për linjën e kontrollit nga pika e lidhjes në dhomën e kompensimit.

Nëse linja e kontrollit është e lidhur sipër mesit të flanaxhës së hyrjes së valvulit, instaloni dhomën e kompensimit në të njëjtin nivel si pika e lidhjes së presionit të rrjedhës së sipërme. Presioni shtesë i kokës së kondensimit (H_k , Fig. 5-3) duhet të kompensohet duke rregulluar pikën e caktuar.

Valvuli me gjilpërë

Nëse rregullatori ka prirjen të lëvizë, ju rekomandojmë të instaloni një valvul me gjilpërë në lidhjen e linjës së kontrollit (16) krahas bashkueses standarde me vidhosje SAMSON me kufizim.

5.2 Përgatitja për instalimin

Valvuli dhe aktuatori mund të montohen para ose pasi të jetë instaluar valvuli në tubacion. Ju rekomandojmë të instaloni fillimisht valvulin pa aktuatorin në tubacion.

Para instalimit, sigurohuni që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- Valvuli duhet të jetë i pastër.
- Valvuli, aktuatori dhe gjithë tubacioni nuk duhet të jenë të dëmtuar.
- Instaloni një sitë në rrjedhën e sipërme të rregullatorit.
- Të dhënat e valvulit në etiketën e të dhënave (emërtimi i tipit, madhësia e valvulit, materiali, vlera e presionit dhe gama e temperaturës) të përputhen me kushtet e impiantit (madhësia dhe vlera e presionit të tubacionit, temperatura e lëndës etj.). Shihni paragrafin "Shenjat mbi pajisje" për detaje mbi etiketën e të dhënave.
- Rekorderitë e kërkuara ose të nevojshme (shihni paragrafin 'Ndërtimi dhe parimi i operimit') janë instaluar ose përgatitur sipas nevojës, para instalimit të valvulit.

Veproni si më poshtë


- Nxirrni materialet dhe veglat e nevojshme që t'i keni gati gjatë proceseve të instalimit.
- Shpëlajeni tubacionin **para** se të instaloni rregullatorin. Operatori i impiantit është përgjegjës për pastrimin e tubacioneve në impiant.
- Për aplikimet me avull, thajini tubacionet. Lagështia e dëmton pjesën e brendshme të rregullatorit.
- Kontrolloni çdo matës presioni të montuar për t'u siguruar që funksionojnë mirë.

Tabela 5-1: Gjatësitë e hyrjes dhe daljes

a Gjatësia e hyrjes
b Gjatësia e daljes

Gjendja e lëndës së procesit	Kushtet e valvulit	Gjatësia e hyrjes a	Gjatësia e daljes b
Gaz	$Ma \leq 0,3$	2	4
Avujt ¹⁾	$Ma \leq 0,3$	2	4
Lëng	Pa kavitacion/ $w < 3 \text{ m/s}$	2	4
	Kavitacion që prodhon zhurmë/ $w \leq 3 \text{ m/s}$	2	4

1) Pa avull të saturuar



5.3 Instalimi

Rregullatorët e testuar SAMSON jepen në dorëzim si një njësi e montuar. Në raste të tjera, secili nga komponentët e rregullatorit (valvuli, aktuatori dhe linja e kontrollit) jepen në dorëzim veçmas. Në momentin e dorëzimit, komponentët e veçantë duhet të montohen së bashku. Veprimtaritë e listuara më poshtë janë të nevojshme për instalimin dhe përpara ndezjes të rregullatorit.

! SHËNIM

Rrezik dëmtimi i rregullatorit për shkak të forcave të shtrëngimit tepër të larta ose tepër të ulëta.

Respektoni çiftet e specifikuara rrotulluese gjatë shtrëngimit të komponentëve të rregullatorit. Çiftet e rrotullimit shumë të mëdha shkaktojnë konsumim më të shpejtë të pjesëve. Pjesët që janë shumë të lira mund të shkaktojnë rrjedhje.

→ Respektoni çiftet e specifikuara rrotulluese (shihni 'Çiftet rrotulluese' tek shtojca).

! SHËNIM

Rrezik dëmtimi i rregullatorit për shkak të përdorimit të veglave të papërshtatshme.

→ Përdorni vetëm veglat e aprovuara nga SAMSON (shihni 'Veglat' tek shtojca).

! SHËNIM

Rrezik dëmtimi i rregullatorit për shkak të përdorimit të lubrifikantëve të papërshtatshëm.

→ Përdorni vetëm lubrifikantët e aprovuar nga SAMSON (shihni 'Lubrifikantët' tek shtojca).

5.3.1 Instalimi i rregullatorit

1. Mbyllni valvulat mbyllëse në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të rregullatorit, ndërkohë që po e instaloni.
2. Hiqni kapakët mbrojtës nga portat e valvulës para se të instaloni valvulën.
3. Ngriji valvulën duke përdorur mjete ngritëse të përshtatshme në vendin e instalimit. Respektoni drejtimin e rrjedhës në valvul. Shigjeta në valvul tregon drejtimin e rrjedhës.
4. Sigurohuni që të përdoren guarnicionet e duhura të flanaxhave.
5. Shtrëngojeni tubin në valvul pa sforcë.
6. Montoni aktuatorin.

→ Aktuator me diafragmë DN 15 deri 100

- Futni boshtin e aktuatorit (11) në vrimën e traversës (8) tek kapaku ndalues i lëvizjes me kunjën me dy maja (20) dhe shtrëngojeni aktuatorin me dadot (9). Respektoni çiftet e specifikuara rrotulluese (shihni 'Çiftet rrotulluese' tek shtojca).

→ **Aktuatori i shakullit DN 15 deri 50**

- Hiqeni traversën (8) nga valvuli.
- Futeni boshtin e aktuatorit (11) në kapakun ndalues të lëvizjes me kunjën me dy maja (20).
- Drejtoni kolonat (8.1) dhe shtrëngojeni aktuatorin me dadot (8.2). Respektoni çiftet e specifikuara rrotulluese (shihni 'Çiftet rrotulluese' tek shtojca).

→ **Aktuatori i shakullit DN 65 deri 100**

- Hiqeni traversën (8) nga valvuli.
 - Zbërtheni kolonat (8.1).
 - Mbërtheni deri në fund kolonat (8.1) në vrimat e filetuara (8.3) të flanaxhës së aktuatorit.
 - Futeni boshtin e aktuatorit (11) në kapakun ndalues të lëvizjes me kunjën me dy maja (20).
 - Shtrëngoni kolonat (8.1) me dadot (8.2) tek flanaxha e valvulit. Respektoni çiftet e specifikuara rrotulluese (shihni 'Çiftet rrotulluese' tek shtojca).
7. Futeni kunjën me dy maja (20) në kapakun ndalues të lëvizjes.
8. Montoni linjën e kontrollit (17) në valvul dhe në aktuator. Respektoni çiftet e specifikuara rrotulluese (shihni 'Çiftet rrotulluese' tek shtojca).

→ **Me aktuatorë me diafragmë**

- Për **avullin** ose **lëngjet mbi 150 °C** instaloni dhomën e kompensimit dhe mbusheni me lëndën e procesit. Respektoni çiftet e specifikuara rrotulluese (shihni 'Çiftet rrotulluese' tek shtojca).
9. Hapini me ngadalë valvulat mbyllëse në tubacion pasi të jetë instaluar valvuli.

5.3.2 Pastrimi i tubacionit

Ju rekomandojmë ta shpëlani sërish tubacionin me rregullatorin të instaluar, para se ta ndizni.

- Zbërtheni linjën e kontrollit (17) nga trupi i valvulit.
- Mbylleni trupin e valvulit me tapa G ¼ (aksesorët: tapë 8323-0030 dhe gominë 8412-0771).
- Respektoni përmasat e rrjetës së sitës në rrjedhën e sipërme, për grimcat me përmasa maksimale. Përdorni sita për të përshtatur lëndën e procesit.
- Kontrolloni nëse sita ka papastërti sa herë që shpëlani tubacionin dhe nëse nevojitet, pastrojeni atë.

Nëse rregullatori keqfunksionon për shkak të bllokimit pas shpëlarjes së tubacionit, veproni siç përshkruhet në paragrafin "Zgjidhja e problemeve".

5.4 Testi i rregullatorit

▲ RREZIK

Rrezik plasjeje për shkak të hapjes së pasaktë të pajisjes apo të komponentëve nën presion.

Rregullatorët dhe tubacionet janë pajisje presioni që mund të plasjin kur përdoren në mënyrë të pasaktë. Copëzat që fluturojnë ose dalja jashtë e lëndës së procesit nën presion mund të shkaktojë lëndime të rënda e madje deri edhe vdekjen.

Përpara se të punoni me rregullatorin:

- Hiqni presionin e të gjitha pjesëve të impiantit në fjalë dhe të rregullatorit.
- Shkëputni linjën e kontrollit.
- Zbrazeni lëndën e procesit nga të gjitha pjesët e impiantit në fjalë dhe nga valvuli.

▲ RREZIK

Rrezik lëndimi personal për shkak të lëndës së procesit që del nën presion.

- Mos e ndizni rregullatorin derisa të jenë montuar të gjitha pjesët.

▲ PARALAJMËRIM

Rrezik humbjeje të dëgjimit ose shurdhim për shkak të zhurmës së lartë.

Gjatë punës mund të ketë emetime të zhurmës (p.sh. nga kavitacioni ose ndezjet) të shkaktuara nga lënda e procesit dhe kushtet e punës.

- Vishni mbrojtëse për veshët kur punoni afër rregullatorit.

▲ PARALAJMËRIM

Rrezik shtypjeje nga pjesët lëvizëse.

- Mos i futni duart ose gishtat midis sustave të pikës së caktuar ndërkohë që rregullatori është në punë.
- Mos i futni duart ose gishtat midis kolonave dhe sustave të pikës së caktuar ndërkohë që rregullatori është në punë.
- Mos i futni duart ose gishtat midis pllakës së sustës dhe traversës ndërkohë që rregullatori është në punë.
- Para se të filloni çdo lloj pune në rregullator, hiqni presionin e të gjitha pjesëve të impiantit dhe të rregullatorit.

▲ PARALAJMËRIM

Rrezik djegieje për shkak të komponentëve dhe tubacioneve të nxehta ose shumë të ftohta.

Në varësi të lëndës së procesit, komponentët e valvulit dhe tubacionet mund të nxehen ose të ftohen shumë dhe të shkaktojnë djegieje.

- Vishni veshje mbrojtëse dhe doreza sigurie.

Rregullatorët SAMSON dorëzohen në gjendje pune. Për të testuar funksionimin e rregullatorit para se ta ndizni ose ta vini sërish në punë, kryeni testet e mëposhtme:

5.4.1 Testi i rrjedhjeve

Operatori i impiantit është përgjegjës për kryerjen e testit të rrjedhjeve dhe për zgjedhjen e metodës së testimit. Testi i rrjedhjeve duhet të jetë në pajtim me kërkesat e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të vlefshme në vendin e instalimit.

Këshillë

Departamenti i pas-shitjes së SAMSON mund t'ju ndihmojë të planifikoni dhe të bëni një test rrjedhjesh për impiantin tuaj.

1. Hapeni me ngadalë valvulin mbyllës të instaluar në rrjedhën e sipërme të rregullatorit.
2. Aplikoni presionin e nevojshëm të testit.
3. Kontrolloni rregullatorin nëse ka rrjedhje në atmosferë.
4. Hiqni presionin nga seksioni i tubacionit dhe shpëlani valvulin.
5. Riparoni gjithë pjesët që kanë rrjedhje dhe përsëritni testin e rrjedhjeve.

5.4.2 Testi i presionit

Shënim

Operatori i impiantit është përgjegjës për bërjen e testit të presionit. Departamenti i pas-shitjes së SAMSON mund t'ju ndihmojë të planifikoni dhe të bëni një test presioni për impiantin tuaj.

SHËNIM

Rrezik dëmtimi i valvulit për shkak të një rritjeje të papritur presioni dhe që rezulton në shpejtësi të larta të rrjedhës.

→ Hapni me ngadalë valvulat.

Gjatë testit të presionit, sigurohuni që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- Mos e lejoni presionin të tejkalojë me 1,5 herë vlerën e presionit në trupin e valvulit.
- Rregullatori duhet të qëndrojë i hapur. Për këtë arsye, vendosni pikën e caktuar maksimale për të garantuar që rregullatori nuk do të mbyllet. Përndryshe, shkëputni linjën e kontrollit dhe mbyllni vrimën tek trupi i valvulit me një tapë G ¼ (aksesorët: tapë 8323-0030 dhe gominë 8412-0771).
- Sigurohuni që presioni të rritet njëkohësisht si në rrjedhën e sipërme ashtu edhe në atë të poshtme të rregullatorit, për të shmangur dëmtim të shakullit balancues.

5.5 Izolimi

5.5.1 Izolimi për temperatura të lëndës mbi 150 °C

Vetëm trupi i valvulit duhet të izolohet deri tek sustat e pikës së caktuar, maksimumi për temperatura të lëndës mbi 150 °C.

! SHËNIM

Rrezik dëmtimi i rregullatorit për shkak të izolimit të pasaktë.

Izoloni vetëm rregullatorin deri tek sustat e pikës së caktuar, maksimumi për temperatura të lëndës mbi 150 °C.

→ Mos i izoloni linjat e kontrollit, dhomat e kompensimit ose aktuatorët me diafragmë.

5.5.2 Izolimi në të ftohtë

Për të izoluar sistemet e ftohta, rekomandojmë të mbushni fillimisht impiantin dhe ta shpëlani atë me kujdes. Rregullatori nuk duhet të izolohet ende në këtë fazë.

! SHËNIM

Rrezik dëmtimi i rregullatorit për shkak të izolimit të pasaktë.

- Izoloni vetëm rregullatorin deri tek aktuatori për temperatura të lëndës nën 0 °C.
- Nëse valvuli ka një sustë të jashtme, ai duhet të mbrohet nga një këmishë që nuk e prek. Boshti i aktuatorit me sustë nuk duhet të bjerë në kontakt me izolimin në të ftohtë.

1. Ndizni impiantin dhe rregulloni pikën e caktuar (shihni paragrafin 'Ndezja).
2. Fikeni impiantin sërish dhe lëreni të ngrohet derisa uji i kondensimit të jetë tharë.
3. Izoloni rregullatorin dhe tubat që përcjellin lëndën e procesit, duke përdorur materiale izoluese me një barrierë avujsh uji. Nëse linja e kontrollit duhet të rrugëzohet pas izolimit, duhet të bëni kujdes të veçantë me mbylljen pasi mund të ndodhin ndryshime të vogla në formë. Trashësia e izolimit varet nga temperatura e lëndës dhe nga kushtet e ambientit. 50 mm është trashësia e zakonshme.

6 Vënia në punë

Puna që përshkruhet në këtë paragraf duhet të kryhet vetëm nga një personel i kualifikuar përkatësisht.

⚠ RREZIK

Rrezik lëndimi personal për shkak të lëndës së procesit që del nën presion.

- Vëreni në punë për herë të parë rregullatorin pasi të keni montuar të gjitha pjesët.

⚠ PARALAJMËRIM

Rrezik djegieje për shkak të komponentëve dhe tubacionit të nxehtë ose të ftohtë.

Komponentët e rregullatorit dhe tubacioni mund të nxehen ose të ftohen shumë. Rrezik djegiejeje.

- Lëri komponentët dhe tubacionet të ftohen ose të ngrohen.
- Vishni veshje mbrojtëse dhe doreza sigurie.

⚠ PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi personal për shkak të komponentëve nën presion dhe lëndës së procesit që del nën presion.

- Mos e lironi linjën e kontrollit ndërkohë që valvuli është nën presion.

⚠ PARALAJMËRIM

Rrezik humbjeje të dëgjimit ose shurdhim për shkak të zhurmës së lartë.

Gjatë punës mund të ketë emetime të zhurmës (p.sh. nga kavitacioni ose ndezjet)

të shkaktuara nga lënda e procesit dhe kushtet e punës.

- Vishni mbrojtëse për sytë kur punoni afër valvulit.

⚠ PARALAJMËRIM

Rrezik shtypjeje nga pjesët lëvizëse.

- Mos i futni duart ose gishtat midis sustave të pikës së caktuar ndërkohë që rregullatori është në punë.
- Mos i futni duart ose gishtat midis kolonave dhe sustave të pikës së caktuar ndërkohë që rregullatori është në punë.
- Mos i futni duart ose gishtat midis pllakës së sustës dhe traversës ndërkohë që rregullatori është në punë.
- Para se të filloni çdo lloj pune në rregullator, hiqni presionin e të gjitha pjesëve të impiantit dhe të rregullatorit.

Para se ta ndiqni apo të rivendosni valvulin në punë, sigurohuni që të respektoni kushtet e mëposhtme:

- Rregullatori është instaluar si duhet në tubacion (shihni paragrafin 'Instalimi').
- Testet për rrjedhjet dhe funksionimin janë kryer me sukses (shihni 'Testimi i rregullatorit').
- Kushtet mbizotëruese në pjesën e prekur të impiantit janë në pajtim me kërkesat e përmasave të rregullatorit (shihni informacionet te 'Përdorimi i synuar' në seksionin 'Udhëzimet dhe masat e sigurisë').

Ndezja/rivendosja e valvulit në punë.

1. Në varësi të fushës së aplikimit, lëreni rregullatorin të ftohet ose të ngrohet për të arritur temperaturën e ambientit para vënies në punë.
2. Hapni me ngadalë valvulat mbyllëse në tubacion. Duke i hapur ngadalë këto valvula, shmangët rritja e papritur e presionit, gjë që shkakton shpejtësi të larta që mund ta dëmtojnë valvulin.
3. Kontrolloni rregullatorin për t'u siguruar që funksionon mirë.

Para se të ndizni impiantin, sigurohuni që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- Linja e kontrollit duhet të jetë e hapur dhe e lidhur mirë.

6.1 Ndezja e impiantit

1. Hapni valvulat mbyllës ngadalë, mundësisht duke filluar nga ana e presionit të rrjedhës së sipërme. Pas kësaj, hapni të gjitha valvulat në anën e konsumatorit (rrjedha e poshtme e rregullatorit).
2. Mbusheni impiantin me **ngadalë** me lëndën e procesit. Shmangni rritjet e papritura të presionit.
3. Sigurohuni që presioni të rritet njëkohësisht si në rrjedhën e sipërme ashtu edhe në atë të poshtme të rregullatorit, për të shmangur dëmtim të shakullit balancues.

6.1.1 Rregullimi i lëngjeve

- Për të vënë në punë rregullatorin e presionit, hapni me **ngadalë** valvulat mbyllëse.
- Për temperaturat mesatare të lëngut mbi 150 °C, në fillim mbushni dhomën e kondensimit me lëndën e procesit. Veproni si më poshtë:
 1. Zhvidhosni tapën e mbushësit nga dhoma e kompensimit.
 2. Përdorni hinkën e posaçme plastike ose një kanë për të shtuar lëndën e procesit derisa të fillojë të derdhet.
 3. Mbërtheni sërish tapën e filtrit dhe shtrëngojeni atë.

6.1.2 Rregullimi i avullit

1. Zhvidhosni tapën e mbushësit nga dhoma e kompensimit.
2. Përdorni hinkën e posaçme plastike ose një kanë për të shtuar ujin derisa të fillojë të derdhet.
3. Mbërtheni sërish tapën e filtrit dhe shtrëngojeni atë.
 - Të gjithë tubat që përcjellin lëndën e procesit duhet të zbrazen komplet dhe të thahen (për të parandaluar goditjen e avullit).
 - Ajri dhe lënda e kondensuar duhet të lihen të shkarkohen nga impianti.
 - Lërimi kohë tubave dhe valvulave që të nxehen.

7 Operimi

Menjëherë pasi ta ndizni ose ta keni vendosur rregullatorin në punë (shihni paragrafin 'Ndezja'), rregullatori është gati për t'u përdorur.

⚠ PARALAJMËRIM

Rrezik djegieje për shkak të komponentëve dhe tubacionit të nxehtë ose të ftohtë.

Komponentët e rregullatorit dhe tubacioni mund të nxehen ose të ftohen shumë. Rrezik djegieje.

- Lërimi komponentët dhe tubacionet të ftohen ose të ngrohen.
- Vishni veshje mbrojtëse dhe doreza sigurie.

⚠ PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi personal për shkak të komponentëve nën presion dhe lëndës së procesit që del nën presion.

- Mos e lironi linjën e kontrollit ndërkohë që valvuli është nën presion.

⚠ PARALAJMËRIM

Rrezik humbjeje të dëgjimit ose shurdhim për shkak të zhurmës së lartë.

Gjatë punës mund të ketë emetime të zhurmës (p.sh. nga kavitacioni ose ndezjet) të shkaktuara nga lënda e procesit dhe kushtet e punës.

- Vishni mbrojtëse për sytë kur punoni afër valvulit.

⚠ PARALAJMËRIM

Rrezik shtypjeje që lind nga pjesët lëvizëse.

- Mos i futni duart ose gishtat midis sustave të pikës së caktuar ndërkohë që rregullatori është në punë.
- Mos i futni duart ose gishtat midis kolonave dhe sustave të pikës së caktuar ndërkohë që rregullatori është në punë.
- Mos i futni duart ose gishtat midis pllakës së sustës dhe traversës ndërkohë që rregullatori është në punë.
- Para se të filloni çdo lloj pune në rregullator, hiqni presionin e të gjitha pjesëve të impiantit dhe të rregullatorit.

7.1 Rregullimi i pikës së caktuar

- Presioni i nevojshëm i rrjedhës së poshtme vendoset duke rrotulluar rregulluesin e pikës së caktuar (6) me anën e një çelësi me fund të hapur.
 - DN 15 deri 50 me gjerësi midis buzëve SW 19
 - DN 65 dhe 100 me gjerësi midis buzëve SW 24
 - Pika e caktuar e rregullatorit prej inoksi duhet të rregullohet duke përdorur litarin e përfshirë.
- Rrotullojeni rregulluesin e pikës së caktuar në drejtim orar (↻) për të rritur pikën e caktuar të presionit.
- Rrotullojeni rregulluesin e pikës së caktuar në drejtim kundërorar (↺) për të reduktuar pikën e caktuar të presionit.

Operimi

Matësi i presionit që ndodhet në anën e presionit të rrjedhës së poshtme mundëson monitorimin e pikës së caktuar të rregulluar.

Rregullimi i pikës së caktuar mund të bëhet gjithashtu duke ndryshuar tensionin e sustës derisa të arrihet distanca x (shihni Fig. 7-1 dhe Tabela 7-1).

i Shënim

Kini parasysh se gjatë rregullimit fillestar të pikës së caktuar, kryhet vetëm një rregullim i përafërt duke rrotulluar rregulluesin e pikës së caktuar derisa të arrihet distanca x .

Veçoritë speciale të lëndës së procesit dhe impianti nuk merren parasysh në këtë rast. Kontrolloni presionin tek matësi i presionit në rrjedhën e poshtme të rregullatorit për rregullimin e saktë të pikës së caktuar.




Tabela 7-1: Rregullimi i pikës së caktuar - Dimensioni x

Gama e pikës së caktuar:	Përmasat e valvulit DN			
	15 deri 25	32 deri 50	65 deri 100	
8 deri 16 bar				
Pika e caktuar 10 bar	$x=89$ mm	$x=106$ mm	$x=133$ mm	
12 bar	$x=97$ mm	$x=117$ mm	$x=150$ mm	
14 bar	$x=104$ mm	$x=128$ mm	$x=168$ mm	
4.5 deri 10 bar				
Pika e caktuar 5,9 bar	$x=85$ mm	$x=100$ mm	$x=131$ mm	
7,3 bar	$x=93$ mm	$x=112$ mm	$x=152$ mm	
8,6 bar	$x=101$ mm	$x=123$ mm	$x=172$ mm	
2 deri 5 bar				
Pika e caktuar 2,8 bar	$x=83$ mm	$x=97$ mm	$x=126$ mm	
3,5 bar	$x=92$ mm	$x=110$ mm	$x=170$ mm	
4,3 bar	$x=100$ mm	$x=122$ mm	$x=184$ mm	
0.8 deri 2.5 bar				
Pika e caktuar 1,2 bar	$x=79$ mm	$x=92$ mm	$x=117$ mm	
1,7 bar	$x=89$ mm	$x=106$ mm	$x=142$ mm	
2,1 bar	$x=99$ mm	$x=121$ mm	$x=167$ mm	
0.2 deri 1.2 bar				
Pika e caktuar 0,45 bar	$x=71$ mm	$x=81$ mm	$x=98$ mm	
0,70 bar	$x=83$ mm	$x=98$ mm	$x=127$ mm	
1,0 bar	$x=95$ mm	$x=117$ mm	$x=157$ mm	
0.1 deri 0.6 bar				
Pika e caktuar 0,23 bar	$x=71$ mm	$x=81$ mm	$x=98$ mm	
0,35 bar	$x=83$ mm	$x=98$ mm	$x=127$ mm	
0,48 bar	$x=95$ mm	$x=115$ mm	$x=157$ mm	
0.05 deri 0.25 bar				
Pika e caktuar 0,10 bar	$x=70$ mm	$x=80$ mm	$x=92$ mm	
0,15 bar	$x=81$ mm	$x=95$ mm	$x=116$ mm	
0,20 bar	$x=91$ mm	$x=110$ mm	$x=139$ mm	

8 Defektet

8.1 Zgjidhja e problemeve

Defekti	Arsyet e mundshme	Veprimi i rekomanduar
Presioni i rrjedhës së poshtme e tejkalon pikën e caktuar të rregulluar.	Pulse presioni të pamjaftueshme në diafragmën e operimit	→ Lidhni linjën e kontrollit në vend për rregullatorët me linjë të jashtme kontrolli. → Pastroni linjën e kontrollit dhe vidhosni reduktorët.
	Grimca të huaja pengojnë tapën	→ Hiqni grimcat e huaja. → Kur dëmtohen pjesët, kontaktoni shërbimin e pas-shitjes së SAMSON.
	Foleja dhe tapa janë të konsumuara ose rrjedhin.	→ Kur dëmtohen pjesët, kontaktoni shërbimin e pas-shitjes së SAMSON.
	Linja e kontrollit është bllokuar	→ Pastroni linjën e kontrollit dhe vidhosni reduktorët.
	Presioni i ngecur në vendin e gabuar (rregullator me linjë të jashtme kontrolli)	→ Rilidhni linjën e kontrollit në një pikë tjetër. → Mos e lidhni linjën e kontrollit në pjesët e kthyer a ose në qafat e tubit.
	Rregullatori ose koeficienti K_{VS}/C_V shumë të mëdha	→ Kontrolloni përmasat. → Ndryshoni koeficientin K_{VS}/C_V , nëse nevojitet ose instaloni një rregullator me përmasa të tjera. → Kontaktoni shërbimin e pas-shitjes së SAMSON.
	Dhoma e kompensimit në pozicion të gabuar ose shumë e vogël (me avull)	→ Rilidhni dhomën e kompensimit në një vend tjetër ose ndërrojeni atë (shihni shtojcën).
	Diafragma e operimit me defekt	→ Ndërroni diafragmën e dëmtuar.
Presioni i rrjedhës së poshtme luhetat	Rregullatori ose koeficienti K_{VS}/C_V shumë të mëdha	→ Kontrolloni përmasat. → Ndryshoni koeficientin K_{VS}/C_V , nëse nevojitet ose instaloni një rregullator me përmasa të tjera. → Kontaktoni shërbimin e pas-shitjes së SAMSON.
	Presioni i ngecur në vendin e gabuar (rregullator me linjë të jashtme kontrolli)	→ Rilidhni linjën e kontrollit në një pikë tjetër. → Mos e lidhni linjën e kontrollit në pjesët e kthyer a ose në qafat e tubit.
	Kufizimi në linjën e kontrollit për lidhjen e presionit është shumë i madh ose mungon.	→ Instaloni një mjet kufizimi. → Instaloni një mjet më të vogël kufizimi.

Defektet

Defekti	Arsyet e mundshme	Veprimi i rekomanduar
Reagim i ngadaltë kontrolli	Kufizimi në bashkuesen e vidës së aktuatorit është i ndotur ose shumë i vogël	→ Pastroni bashkuesen e vidës ose instaloni bashkuese më të madhe vide.
	Në linjën e kontrollit ka papastërti.	→ Pastroni linjën e kontrollit.
Presioni i rrjedhës së poshtme bie nën pikën e caktuar të rregulluar.	Rregullatori është instaluar kundër rrjedhës	→ Instaloni rregullatorin në mënyrë të tillë që drejtimi i rrjedhës të përputhet me drejtimin e treguar nga shigjeta në trup.
	Rregullatori ose koeficienti K_{VS}/C_V shumë të vogla	→ Kontrolloni përmasat. → Ndryshoni koeficientin K_{VS}/C_V , nëse nevojitet ose instaloni një rregullator me përmasa të tjera. → Kontaktoni shërbimin e pas-shitjes së SAMSON.
	Presioni i ngecur në vendin e gabuar (rregullator me linjë të jashtme kontrolli)	→ Rilidheni linjën e kontrollit në një pikë tjetër. → Mos e lidhni linjën e kontrollit në pjesët e kthyer ose në qafat e tubit.
	Grimca të huaja pengojnë tapën	→ Hiqni grimcat e huaja. → Kur dëmtohen pjesët, kontaktoni shërbimin e pas-shitjes së SAMSON.
	Dhoma e kompensimit në pozicion të gabuar ose shumë e vogël (me avull)	→ Rilidhni dhomën e kompensimit në një vend tjetër ose ndërrojeni atë (shihni shtojcën).
	Linja e kontrollit është bllokuar	→ Pastroni linjën e kontrollit dhe vidhosni reduktorët.
	Sita është bllokuar	→ Pastroni sitën.
Reagim i befte kontrolli	Fërkim i rritur, p.sh. për shkak të grimcave të huaja midis folesë dhe tapës	→ Hiqni grimcat e huaja. → Kur dëmtohen pjesët, kontaktoni shërbimin e pas-shitjes së SAMSON.
Zhurma të forta	Shpejtësi e lartë e rrjedhës, kavitacion	→ Kontrolloni përmasat. → Instaloni rregullator më të madh, nëse nevojitet. → Instaloni ndarës rrjedhe me gaze dhe avull.
Në aktuator ka rrjedhje	Diafragma/shakulli i operimit ka defekt	→ Ndërroni diafragmën/shakullin e dëmtuar.
Në gominën e shakullit ka rrjedhje	Gomina e shakullit ka defekt	→ Kur dëmtohen pjesët, kontaktoni shërbimin e pas-shitjes së SAMSON.
Në treguesin e çarjes së diafragmës shfaqen shenja të kuqe (aktuator me dy diafragma).	Diafragma e operimit me defekt	→ Ndërroni diafragmën e dëmtuar të operimit.

i Shënim

Kontaktioni shërbimin e pas-shitjes së SAMSON për defektet që nuk janë në tabelë.

Keqfunksionimet e listuara në paragrafin 8.1 shkaktohen nga defekte mekanike dhe përmasa të pasakta të rregullatorit. Në rastin më të thjeshtë, funksionimi mund të rivendoset duke ndjekur veprimin e rekomanduar. Për ndreqjen e defektit mund të nevojiten vegla të veçanta.

Kushtet e jashtëzakonshme të operimit dhe të instalimit mund të shkaktojnë ndryshim të situatave, gjë që mund të ndikojë në reagimin e kontrollit dhe në keqfunksionime. Për zgjidhjen e problemeve, kushtet e tilla si instalimi, lënda e procesit, kushtet e temperaturës dhe të presionit, duhet të merren në konsideratë.

 Këshillë

Departamenti i pas-shitjes së SAMSON mund t'ju ndihmojë të hartoni një plan kontrolli dhe testimi për impiantin tuaj.

8.2 Veprimi i emergjencës

Operatori i impiantit është përgjegjës për veprimet e emergjencës që duhen ndërmarë në impiant.

Rekomandojmë heqjen e rregullatorit nga tubacioni para se ta riparoni atë.

Në rast të një defekti të rregullatorit:

1. Mbyllni valvulat në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të rregullatorit për të ndaluar rrjedhën e materialit të procesit në rregullator.
2. Merruni me zgjidhjen e problemeve (shihni paragrafin 8.1).
3. Ndreqini këto keqfunksionime që mund të ndreqen bazuar në udhëzimet e dhëna këtu. Kontaktioni shërbimin tonë të pas-shitjes në gjithë rastet e tjera.

Vënia e valvulës përsëri në punë pas një defekti.

Shihni paragrafin 'Ndezja'.

9 Shërbimi

Rregullatori nuk kërkon asnjë mirëmbajtje. Megjithatë, është subjekt i konsumimit, veçanërisht tek foleja, tapa dhe diafragma e operimit/shakullit. Në varësi të kushteve të punës, kontrolloni rregullisht rregullatorin për të parandaluar keqfunksionime të mundshme. Operatorët mbajnë përgjegjësi për hartimin e një plani kontrolli dhe testimi. Detajet për defektet dhe mënyrën se si t'i ndreqni ato, mund t'i gjeni në paragrafin "Keqfunksionimet".

Puna që përshkruhet në këtë paragraf duhet të kryhet vetëm nga një personel i kualifikuar përkatësisht.

Rekomandojmë heqjen e rregullatorit nga tubacioni para se të kryeni çdo proces mirëmbajtjeje ose shërbimi.

⚠ PARALAJMËRIM

Rrezik djegieje për shkak të komponentëve dhe tubacionit të nxehtë ose të ftohtë.

Komponentët e rregullatorit dhe tubacioni mund të nxehen ose të ftohen shumë. Rrezik djegieje.

- Lëri komponentët dhe tubacionet të ftohen ose të ngrohen.
- Vishni veshje mbrojtëse dhe doreza sigurie.

⚠ PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi personal për shkak të lëndës së procesit të mbetur në rregullator.

Ndërsa punoni në rregullator, mund të dalë lënda e mbetur e procesit dhe, në varësi të karakteristikave të saj, mund të çojë në lëndime personale, p.sh. djegie (kimike).

- Vishni veshje mbrojtëse, doreza sigurie dhe syze mbrojtëse.

⚠ SHËNIM

Rrezik dëmtimi i rregullatorit për shkak të forcave të shtrëngimit tepër të larta ose tepër të ulëta.

Respektoni çiftet e specifikuar rrotulluese gjatë shtrëngimit të komponentëve të rregullatorit. Çiftet rrotulluese tepër të larta bëjnë që pjesët të konsumohen më shpejt. Pjesët që janë shumë të lira mund të shkaktojnë rrjedhje.

